

Banka Ekonomike

Manuali për përdorimin e Platformës E-banking për Klient

Përmbajtja:

1. Qëllimi.....	3
2. Sqarim i nocioneve.....	3
3. Shërbimet e ofruara në E-banking	4
4. Qasja në E-banking	4
5. Dritarja kryesore E-banking(karakteristikat e përgjithshme)	6
6. Kontrollimi i gjendjes së llogarisë/ve.....	6
7. Shembull i kontrollimit të gjendjes së llogarisë rrjedhëse në EURO	8
8. Procesimi i transfereve	9
8.1. Inicimi i transferit.....	9
8.2. Transferi Personal	11
8.3. Transferi personal me kurs-këmbimi	13
8.4. Transferet brenda bankës	15
8.5. Regjistrimi i transfereve për Banka Tjera në Kosovë.....	17
8.6. Regjistrimi i transferit ndërkombëtar.....	19
8.6.1. Informatat e përgjithshme.....	19
8.6.2. Regjistrimi i transferit ndërkombëtar në Ebanking.....	20
8.7. Pagesat e shumëfishta	23
8.8. Krijimi dhe ruajtja e transferit të shpeshtë.....	26
8.9. Kopja e transferit.....	28
9. Regjistrimi i faturave KOS GIRO.....	28
9.1. Pagesa e faturave KOS GIRO të lëshuara nga KESC	29
9.2. Procesimi i Faturave KOS Giro të lëshuar nga Dogana e Kosovës.....	32
9.3. Faturat Kos Giro e lëshuar nga Kompanit e Sigurimeve	34
10. Realizimin e pagesave të faturave për Agjensionet e ndryshme buxhetore	37
10.1. Procesimi i fletëpagesës për Taksa dhe Pensione	38
10.2. Regjistrimi i pagesave për ATK	40
10.3. Regjistrimi i Pagesave për Universitetin e Prishtinës.....	41
11. Menaxhimin e Pagesave Periodike (Standing Order).....	41

1. Qëllimi

Qëllimi i i këtij manuali është të informoheni për përdorimin e platformës E-banking të Bankës Ekonomike. Në këtë manual mund të gjeni veçorit kryesore të platformës, që nga qasja deri te përdorimi i shërbimeve bankare.

Për çdo pyetje eventuale gjatë përdorimit të platformës E-banking, ju lutem na kontaktoni në shërbimin tonë të thirrjeve (24/7) në numrat:

+381 38/500 500

+386 49/733 322

2. Sqarim i nocioneve

Për tu konfirmuar: transferet për të cilat nevojitet konfirmimi i përdoruesve të tjerë. Ky seksion përmban transferet vetëm nëse ato i përkasin një kontrate ku përdoruesit nuk kanë autorizim për të nënshkruar vetë. Është e mundur të konfirmohen disa transfere në të njëjtën kohë duke i përzgjedhur ato dhe duke klikuar në Detajet e përzgjedhura. Lista e punës paraqet transferet që mund të konfirmohen. Është e mundur që të konfirmohen transferet një nga një apo të gjitha së bashku, varësisht nga kufizimet dhe autorizimet e aplikueshme.

Në pritje: transferet me një datë të ardhshme të ekzekutimit. Këto transferet do të procesohen në mëngjesin e datës së caktuar

Në proces: transferet që janë duke u procesuar ose janë në fazën e verifikimit nga Transferet ndërkombëtare normalisht kanë statusin "aktuale" për disa orë para se ato të ekzekutohen.

Ekzekutimi: transferet që janë procesuar dhe regjistruar në mënyrë korrekte.

Ju lutem vini re: ekzekutimi i transferet gjithmonë varet nëse ka fonde të mjaftueshme në llogarinë përkatëse si dhe nga kushtet teknike të sistemeve të ndryshme të përfshira. Prandaj mund të ndryshoj kohëzgjatja për procesim.

Të anuluar: transferet e anuluar nga përdoruesi ose nga sistemi. Në rastin e fundit, transferi i anuluar do të jetë subjekt i mesazhit që shfaqet në Faqen kryesore në seksionin e mesazheve.

Mund të filtrohet lista sipas llogarisë që do të debitohet, llojit, pagesës së vetme/të shumëfishtë, shumës dhe datës. Ju mund të zgjidhni një ose më shumë transfere për të marrë një listë të transfereve. Disa transfere kanë një sërë veprimesh shoqëruese, të cilat varen nga statusi i saj: detaje, kopjo, ndrysho, anulo. Ju mund t'i shikoni këto veprime duke klikuar në ikonën pranë transferit.

Mundeni të zgjidhni një transfer të vetme (duke klikuar në ikonën Lloji ose në kutinë në anën e majtë) ose një numër të transfereve dhe të shihni detajet relevante. Nga lista e detajeve, mundeni të kryeni operacione të ndryshme, varësisht nga statusi i transfereve.

3. Shërbimet e ofruara në E-banking

Platforma E-banking e Bankës Ekonomike është e zhvilluar në përputhje me nevojat dhe kërkesat e klientëve. Me shërbimin E-banking nuk do të keni nevojë të vini në Degët e bankës për të marrë informata për lëvizjet financiare në llogaritë e juaja apo të iniconi transfer parash brenda dhe jashtë vendit apo të kryeni pagesat e faturave të ndryshme (Kos Giro apo Pagesat e taksave).

Për tu qasur në platformën E-banking, mjafton të keni qasje në internet dhe ti keni kredencialet e nevojshme, të specifikuar me poshtë për qasje në E-banking dhe mund ti kryeni të gjitha shërbimet bankare në përputhje me Kushtet e përgjithshme të bankës.

Platforma E-banking ju mundëson kryerjen e këtyre shërbimeve bankare:

- Kontrollimin e gjendjes së llogarive bankare
- Regjistrimin e transferit personal (brenda llogarisë së të njëjtit klient)
- Regjistrimin e transferit për klient brenda Bankës Ekonomike
- Regjistrimin e transferit për klient të bankave tjera në Kosovë
- Regjistrimin e pagesës së faturës KOS GIRO
- Regjistrimin e pagesës së faturës për agjensionet e ndryshme buxhetore të Kosovës
- Regjistrimin e transferit ndërkombëtar
- Regjistrimin e transfereve të shumëfishta (e përshtatshme për pagesën e pagave)
- Menaxhimin e Pagesave Periodike (të njohura edhe Standing Order)
- Krijimin dhe ruajtjen e shablloneve të transfereve
- Kopjimin e transferit

Përveq këtyre funksioneve operacionale, platforma E-banking ju mundëson menaxhim fleksibil të platformës, ku ju vet mund ti parametrizoni disa funksione, si gjuha, paraqitja e llogarive në dritaren kryesore duke klikuar në butonin




për parametrizim personal të dritares. Profilet e përdoruesve, janë dizajnuar në përputhje të plotë me standardin e niveleve të autorizimit në bank, dhe ju mund të përcaktoni profilin me të drejta të plota apo të limituara për personin që dëshironi ta autorizoni në E-banking.

4. Qasja në E-banking


Qasje në E-banking kanë të gjithë klientët që kanë nënshkruar kontratën për shërbimin e E-bankingut në njërën nga Degët e Bankës Ekonomike. Për tu qasur në platformën E-banking duhet të hapni faqen e siguruar dhe të çertifikuar nga Banka Ekonomike në internet:

<https://E-banking.bekonomike.com>


Për tu kyqur në e-banking duhet të klikoni në linkun e paracaktuar, ku do të shfaqet dritarja në vijim:




Në rubrikën Shfrytëzuesi dhe Fjalëkalimi duhet të vendosni kredencialet që i keni marrë në bankë, dhe pasi të shtypni butonin "Hyrja",



Pastaj kërkohet vendosja e kodit secret të cilin do ta pranoni në telefonin tuaj mobil që e keni deponuar në Bankë, shenoni kodin e pranuar dhe klikoni në butonin "OK", dhe pastaj hapet dritarja kryesore E-banking e cila duket si në figurën me poshtë:



5. Dritarja kryesore E-banking(karakteristikat e përgjithshme)


Në faqën  "shtëpi" të njohur edhe si "home" paraqiten funksionet kryesore të E-banking. Në këtë dritare mund të shikoni mjetet e juaja në dispozicion, duke përfshirë edhe obligimet (kredit) e juaja, mund të iniconi transferet e ndryshme dhe të parametrizoni përdorimin E-banking sipas nevojave tuaja. Informata me të detajuara rreth përdorimit të E-bankig përveç këtij manuali, mund ti gjeni tek lidhëza "Ndihma" (gjendet në anën e majt të dritarës) e cila është e ndërlidhur me secilën dritare ku ju jeni duke punuar.

Për inicim më të shpejtë të transfereve, mund të klikoni mbi butonin përkatës të transfereve dhe do hapet dritarja për regjistrimin e transferit të caktuar në E-banking.

6. Kontrollimi i gjendjes së llogarisë/ve

Për të kontrolluar gjendjen e llogarisë suaj, tek butoni " Bilanci" , gjeni butonin "Vlera" dhe ju paraqitet një përmbledhje e pasurisë dhe obligimeve tuaja. Për ta shikuar gjendjen në llogaritë rrjedhëse apo të kursimit, duhet të klikoni te vegëza "Likuiditeti" dhe do ju paraqitën të gjitha llogarit e juaja si në dritarën në vijim.

Nga kjo dritare mund të kontrolloni gjendjen e përgjithshme të secilës llogari, ndërsa për detaje duhet të klikoni tek vegëza përkatëse.



10.0.0.117:8081/app/home

1001228745 (Hyrja e fundit: 23.05.2016 20:50) SO SO LINDITA MEHMETI Dili

Banka Ekonomike

LLOGARITE TRANSFERET PARAMETRAT

Lajmet Dhe Mesazhet

Bilanci

Klienti: SO LINDITA MEHMETI

Vlera: 2.423,16 EUR

Kreditë: -1.566,10 EUR

Bilanci: 857,06 EUR

Transferet

Asnjë transfer në proces

3 transferë në pritje


6 transferë të elazkuara në 5 ditët e fundit

1 transfer i anuluar në 5 ditët e fundit

Platforma është shumë fleksibile për kontrollimin e gjendjes së llogarisë, por duhet të keni parasysh se gjendja e llogarisë ndahet në dy grupe kryesore:

1. Vlera- paraqet mjetet financiare në dispozicion në të gjitha nënlllogritë së bashku
2. Kreditë- paraqesin të gjitha obligimet ndaj Bankës Ekonomike

Nëse deshironi të kontrolloni gjendjen e llogarisë të ndonjeres nga nën-llogaritë e ndërlidhura, duhet të klikoni tek plusi, dhe hapen të gjitha llogaritë e ndërlidhura sikurse në figurën më poshtë:



eBanking

10.0.0.117:8081/app/asset

LLOGARITE TRANSFERET PARAMETRAT

Llogaritë

Grupi	Klient, kategori	Valuta, klient	Vlera pozicionit	Vlera EUR	%
Totali				857,06	EUR
Grupimet					
				853,37	21,4%
				853,37	21,4%
				-987,85	-24,8%
				2.403,73	60,3%
				2.403,73	60,3%
				0,00	0,0%
				-987,85	-24,8%
				0,00	0,0%
				0,00	0,0%
				0,00	0,0%
				0,00	0,0%
				0,00	0,0%
				0,00	0,0%
				0,00	0,0%
				15,74	0,4%

Përqindja pas secilës shumë tregon, pjesëmarrjen me përqindje të nënlogarisë së caktuar tek vlera absolute e shumës së mjeteve në dispozicion së bashku me shumën e obligimeve ndaj bankës.


7. Shembull i kontrollimit të gjendjes së llogarisë rrjedhëse në EURO

Klikoni mbi vegezën “Llogarit rrjedhëse” dhe do ju paraqiten llogaritë rrjedhëse në valutat e hapura, prap duhet të klikoni në llogarinë përkatëse për të ju paraqitur gjendja aktuale e llogarisë.

Tek fusha **Filter i shpejt**, mund të zgjidhni :

- **Lëvizjet e fundit**- dhe ju paraqiten 10 transaksionet e fundit,
- **Ditët e fundit**- dhe ju paraqiten transaksionet në 30 ditët e fundit

Për të kontrolluar gjendjen e llogarisë për një kohë me të gjatë (deri në një vit) duhet të klikoni opcionin: **E avancuar** dhe ju hapet dritarja si në vijim:



The screenshot shows the eBanking interface for Banka Ekonomike. The account details for 'EUR LLOGARI RRJEDHESE' are displayed, including the account number, currency (EUR), IBAN, and a credit limit of 2,400.00. The current balance is -987.85 EUR. The transaction history table is shown with the following data:

Data Oper.	Data Valutë	Përshkrimi	Çmimi (EUR)	Bilanci
23.05.16	23.05.16	Preposted movements	-49.00	-1.036,85
23.05.16	23.05.16	eBanking National Tr - 0000001243	-3.80	-987,85
20.05.16	20.05.16	eBanking Intl. Trans - 0000001241	-25,49	-984,05
20.05.16	20.05.16	eBanking Intl. Trans - 0000001239	-25,49	-958,56
20.05.16	20.05.16	eBanking National Tr - 0000001215	-25,80	-933,07

Tek fusha **Data**: mund të përzgjedhni: **Data Oper.**- që nënkupton ditën e regjistrimit apo **Datën Valutës** që nënkupton datën e realizimit të transaksionit.

Tek fusha **Prej**: mund të përzgjidhni datën me të hershme të gjendjes nga kalendari i sistemit

Tek fusha **Deri**: mund të përzgjidhni datën deri kur dëshironi të keni gjendjen nga kalendari

Tek fusha **Përshkrimi**: mund të kërkonti transaksionin bazuar në referencë

Tek fusha **Vlera**: mund të klikoni vetëm katrorin për **Debitat** apo vetëm katrorin për **Kreditat** në llogarinë tuaj apo të klikoni të dyjat dhe paraqitën të gjitha transaksionet.

Tek fusha **Prej** dhe **Deri** mund të përcaktoni vlerat që jeni duke i kërkuar.

Këto veqori për kontrollim të gjendjes së llogarisë vlejné për të gjitha llogaritë e ndërlidhura me E-banking tuaj.

8. Procesimi i transfereve

Të gjitha urdhërtransferet e regjistruara, në E-banking do të procesohen në përputhje më kushtet e përgjithshme të bankës. Për të gjitha shërbimet ju do të paguani një tarifë të caktuar, e cila është e publikuar në listën e çmimeve të Bankës Ekonomike.

Për të inicuar një transfer, duhet të klikoni tek opcionin **Transferet** dhe pastaj hapen optionet:

- **Regjistro transferin** – ky opcion përdoret për iniciimin e regjistrimit të transferit
- **Lista e transfereve** – për të kontrolluar statusin e pagesave
- **Menaxho pagesat e përherëshme** - ky opcion përdoret për të kontrolluar pagesat e përherëshme
- **Menaxho transferet e shpeshta** - ky opcion përdoret për të kontrolluar dhe edituar shabllonat
- **Verifiko limitin e transferit** - ky opcion përdoret për të kontrolluar limitet e fondeve në dispozicion.

8.1. Inicimi i transferit


Para inicimit të transferit, fillimisht, duhet të zgjedhni llogarinë nga e cila deshironi të iniconi transferin, pastaj e zgjedhni llojin e transferit¹ apo të selektoni butonin për transferin përkatës.

- Nga llogaria rrjedhëse në EUR mund të inicohen të gjitha transferat
- Nga llogaria rrjedhëse në USD mund të inicohen vetëm transfera personale dhe transfere ndërkombëtare


¹ Llogaritë janë të paramterizuara me llojet e transfereve, psh nuk mund të inicohet transfer vendor nga llogaria USD apo nuk mund të procesohen transfere për klientë tjerë nga opcionin Transfer Personal

- Nga llogaria rrjedhëse në CHF mund të inicohen vetëm transfera personale dhe transfere ndërkombëtare
- Nga llogaria rrjedhëse në GBP mund të inicohen vetëm transfera personale dhe transfere ndërkombëtare
- Nga llogarit e kursimit mund te inicohen vetëm transfere personale

Për të vazhduar me regjistrimin e cilit do transfer, fillimisht duhet të klikoni tek opcioni **Regjistro Pagesën** apo **të klikoni tek Butoni për Transferin përkatës** dhe ju paraqitët dritarja në vijim:




Nga fusha Llogaria, përzgjidhëni llogarin e juaj, nga e cila dëshironi të iniconi transferin. Në shembullin me poshtë kemi zgjedhur llogarinë rrjedhëse në EUR, e cila ju lejon procesimin e të gjitha llojeve të transferëve:



8.2. Transferi Personal


Për të inicuar një transfer personal (në mes të llogarive të të njëjtit klient), duhet të përzgjidhni opcionin **Transfer personal** , klikoni opcionin **Vazhdo** për tu hapur dritarja ne vijim,apo mund të klikoni direkt mbi butonin e transfereve personale, prap hapet dritarja e njëjtë.



Në fushën Llogaria: duhet të përzgjedhni llogarinë në të cilën dëshironi të transferoni mjete.

Në fushën Vlera: duhet të shenoni shumën që dëshironi të transferoni

Në fushën Arsyeja: duhet të shenoni arsyen pse po e iniconi transferin




The screenshot shows the 'TRANSFERET' section of the eBanking interface. The 'Transfer' form is displayed with the following details:

- Faza e procesit:** Debiti dhe lloji (checked), Te dhënat e transferit, Informatat e ekzekutimit
- Lloji i transferit:** Transfer personal
- Debit:** Klienti: [redacted], Llogaria: XK05140100000000000000000000000000 EUR LLOGARI RRJEDHESE, Bilanci aktual i llogarisë: -987,85 EUR
- Kredit:** Klienti: [redacted], Llogaria: XK05140100000000000000000000000000 EUR Master Card, Bilanci aktual i llogarisë: -578,25 EUR
- Vlera / Përshkrimi:** Vlera: 20 EUR, Përshkrimi: Transfer per Credit Card

Buttons at the bottom include 'Anulo', 'Debiti & lloji', and 'Vazhdo'.

Pas plotësimit të fushave të cekura me lartë, për të vazhduar me procesimin e transferit personal, klikoni opcionin **Vazhdo** dhe paraqitet dritarja si në vijim:



The screenshot shows the 'Informata E Ekzekutimit' section of the eBanking interface. The confirmation screen displays the following details:

- Faza e procesit:** Debiti dhe lloji (checked), Te dhënat e transferit (checked), Informatat e ekzekutimit (checked)
- Lloji i transferit:** Transfer personal
- Debit:** Klienti: [redacted], Llogaria: XK05140100000000000000000000000000 EUR LLOGARI RRJEDHESE, Bilanci aktual i llogarisë: -987,85 EUR
- Përfituesi:** Klienti: [redacted], Llogaria: XK05140100000000000000000000000000 EUR Master Card
- Shuma totale (1 Pagesë):** 20,00 EUR
- Ekzekutim dhe autorizim:** Urdhëresë e vetme (selected), Urdhëresë automatike
- Transferi do të ekzekutohet me:** 24.05.2016
- Ekzekutimi do të varet në fondet e disponueshme në llogarinë debitore në momentin e ekzekutimit. Transferi do të ekzekutohet vetëm njëherë në datën e specifikuar.**
- Pagesë e autorizuar tek 60/60 për datën e zgjedhur**


Buttons at the bottom include 'Anulo', 'Data e transferit', and 'Dërgo transferin'.

Ende keni mundësi të ndryshoni pagesën:

- Mund ta Anulojm, duke klikuar ne butonin **X Anulo** , por mund të kryejm edhe veprime si:
- Mund ta regjistrojm si transferë të përhershëm duke klikuar në **Urdhëres e përhershme**
- Mund ta përcaktojm datën e debitimit të llogarisë

Për të vazhduar procesimin e pagesës, kliko në butonin Dërgo Pagesën dhe pagesa do të procesohet në përputhje me kushtet e përgjithshme të bankës.

Pasi të klikoni butonin Dërgo Pagesën, transferi dërgohet për procesim të mëtutjshëm nga sistemin i bankës, dhe transferi merr statusin përkatës si në figurën më poshte:




8.3. Transferi personal me kurs-këmbimi

Transferi personal me kurs këmbimi mund të bëhet direkt në E-banking nga llogaria e juaj rrjedhëse EUR në njerën nga llogarit rrjedhëse USD,CHF apo GBP dhe anasjelltas deri në vlerën EUR 9999 apo në vlerën ekuivalente të valutave tjera brenda afatit dhe kushteve të paracaktuara në kushtet e përgjithshme të bankës. Kur keni transfer me kurs këmbimi, kursi i blerjes/shitjes merret nga sistemi i bankës.

Kursi i valutave të huaja aplikohet sipas datës së validimit të transaksionit !

Procesi i regjistrimit është i njëjtë, vetëm llogaria pranuese është llogaria rrjedhëse e valutës së caktuar, gjeni një shembull në dritaren më poshtë:




The screenshot shows the 'Pagesa' (Transfer) screen in the online banking system. The interface is in Albanian. At the top, there are navigation tabs for 'PASURIA' and 'PAGESAT'. The main area is divided into sections for 'Debit' and 'Credit'. The 'Debit' section shows the client's account number '106180.1004 ORDINARY' and the current account balance 'Saldo attuale del conto_SQ: 4.912,52 EUR'. The 'Credit' section shows the recipient's account number '106180.1002 ORDINARY' and the current account balance 'Saldo attuale del conto_SQ: 0,00 USD'. A dropdown menu for 'Vlera / Arsyeja' (Amount / Reason) is open, showing options like '106180.1002 ORDINARY', '106180.1400 FLEXI DEPOSIT', '106180.1500 LLOGARI KURSIMI', and '106180.6000 Master Card'. The interface also shows a sidebar with navigation options and a currency exchange table.

Te fusha **Vlera**: mund të shenoni shumën që dëshironi të transferoni dhe mund ta përcaktoni llojin e valutës. Pra, keni mundësi të fiksoni shumën dhe valutën, pavarësisht se nga cila llogari do të debitojeni.

Për shembull: Nëse kursi i këmbimit në mes të valutave EUR/USD është 1.00 EUR=1.09 USD, nëse ju do të iniconi transfer nga llogaria juaj EUR në llogarin e juaj USD, ju mund ta regjistroni duke fiksuar shumën dhe valutën:

- Nëse vendosni vlerën EUR100.00 , llogaria EUR do të debitohet per EUR 100.00 ndërsa llogaria në USD do të kreditohet në USD në vlerën 109.00 USD
- Nëse vendosni vlerën USD 100.00, llogaria EUR do të debitohet EUR 91.75 ndërsa llogaria në USD do të kreditohet për USD 100.00



1 pages për tu konfirmuar
3 pagesat në pritje
28 pagesa pending/të varura
1 pages e ekzekutuar në 5 ditët e fundit

Kursi Këmbimit	
CHF	0.924
GBP	1.423
USD	0.945

Ndihma

Përfituesi
Klienti: [Redacted]
Llogaria: **106180.1002 ORDINARY**

Vlera totale (1 Pagesa) **100,00 EUR**

Ekzekutimi dhe autorizimi
Urdhëresë e vetme Urdhëresë e përhershme

Pagesa do të ekzekutohet në **08.03.2016**

Ekzekutimi do të mvaret në mjetet në dispozicion në kohën e ekzekutimit.
Pagesa do të ekzekutohet vetëm njëherë në datën e treguar.


Pagesa autorizuar për **60/60** datën e selektuar.

Anulo Data pagesës **Dergo Pagesën**

8.4. Transferet brenda bankës

Transferet brenda klientëve të Bankës Ekonomike realizohen duke zgjedhur opcionin:

Transfer BEK



1001228745 (Hyrye e fundit: 24.05.2016 18:28) | 50 | 50 LINDITA MEHMETI | Dënie

Banka Ekonomike

LLOGARITË **TRANSFERET** PARAMETRAT

Transfer
Faza e procesit: Debiti dhe llogji Të dhënat e transferit Informatat e ekzekutimit

Debit
Klienti: **50 LINDITA MEHMETI**
Llogaria: **XK05140100000005029 EUR LLOGARI RRJEDHESE**
Bilanci aktual i llogarisë: **-1.056,85 EUR**


Lloji i transferit
Transfer personal
Transfer ndërkombëtar
Transfer vendor
Gyro pagesat
Pagesat e faturave
Transfer brenda bankës

Transfer brenda bankës
Transferet brenda bankës në valutën EUR në llogaritë e Bankës Ekonomike. Transferet brenda bankës aplikohen komisionet aktuale nga Banka Ekonomike, për më shumë ju lutem i referojuni gënimorës aktuale të Bankës Ekonomike.

Ndihma **Vazhdo**

Të fusha Llogaria/IBAN janë të paravendosura prefiksi: **XK0514**

Kodi **XK05** është kodi ndërkombëtar i llogarive bankare të Kosovës , ndërsa kodi **14** është kodi i të gjitha llogarive bankare të Bankës Ekonomike, dhe si e tillë, shifra **XK0514** mbesin çdo herë të parashkuara tek fusha e llogarisë, ju duhet vetëm ti shtoni edhe 14 shifrat e mbetura të llogarisë bankare të përfituesit që ka llogari në Bankën Ekonomike.



eBanking

10.0.0.117:8081/app/payment?execution=e4s8

LLOGARITË TRANSFERET PARAMETRAT

Informata E Ekzekutimit

Faza e procesit: Debiti dhe lloji Të dhënat e transferit Informatat e ekzekutimit

Lloji i transferit: Transfer brenda bankës

Debit

Klienti: 50 LINDITA MEHMETI Bilanci aktual i llogarisë: -1.056,85 EUR

Llogaria: XK05140100000005029 EUR LLOGARI RRJEDHESE

Përfutuesi

Llogaria/IBAN: XK05 1401 0000 1067 1731 Banka përfutuese: 14 Banka Ekonomike Prishtina

Emri dhe Adresa: Nora Uka

Shuma totale (1 Pagesë) 100,00 EUR

Ekzekutim dhe autorizim

Urdhëresë e vetme Urdhëresë automatike

Transferi do të ekzekutohet me 24.05.2016


Ekzekutimi do të varet në fondet e disponueshme në llogarinë debitore në momentin e ekzekutimit
Transferi do të ekzekutohet vetëm njëherë në datën e specifikuar.

Pagesë e autorizuar tek 60/60 për datën e zgjedhur

Për të konfirmuar pagesën klikoni butonin **Dërgo Pagesën** dhe pagesa do të procesohet në përputhje me Kushtet e përgjithshme të Bankës.

8.5. Regjistrimi i transfereve për Banka Tjera në Kosovë

Për të realizuar një transfer për klientët që kanë llogari në njërën nga bankat tjera në Kosovë, duhet të zgjedhni opcionin Transfer Vendor dhe pastaj klikoni në opcionin Vazhdo:



eBanking

10.0.0.117:8081/app/payment?execution=e5s1

1001228745 (Hyra e furtit: 24.05.2016 18:28) 50 50 LINDITA MEHMETI DITË

**Banka
Ekonomike**

LLOGARITË TRANSFERET PARAMETRAT

Transfer

Faza e procesit: Debiti dhe lloji Të dhënat e transferit Informatat e ekzekutimit

Debit

Klienti: 50 LINDITA MEHMETI Bilanci aktual i llogarisë: -1.056,85 EUR

Llogaria: XK05140100000005029 EUR LLOGARI RRJEDHESE

Lloji i transferit

Transfer personal

Transfer brenda bankës

Transfer vendor

Transfer vendor mund të realizohet vetëm në valutën EUR. Për transferet vendore aplikohen komisionet aktuale nga Banka Ekonomike, për më shumë ju lutem referoju çmimore së Bankës Ekonomike. Ekzekutimi në të njëjtën ditë është i mundur deri në 14:30 për Transfere Normale ndërsa deri në 15:10 për transfere me prioritet!

Vazhdo

Sikurse të transferet tjera edhe këtu e keni mundësin e përzgjedhjes së opcionit:

- **Pagesë e vetme**- e cila përdoret për regjistrimin e një transferi të vetëm

- SWIFT Kodin e Bankës së Përfituesit⁵
- Arsyen e Pagesës
- Llojin e provizionit (SHA/BEN/OUR)⁶
- ITRS kodin e BQK-së⁷
- Nëse pagesa bazohet në dokument të pagueshëm ⁸

8.6.2. Regjistrimi i transferit ndërkombëtar në Ebanking

Për të regjistruar një transfer ndërkombëtar, duhet të klikoni butonin “TRANSFERET”, pastaj klikoni opcionin “Regjistro transferin”, ku ju paraqitën të gjitha llojet e transfereve, duke përfshirë edhe ato ndërkombëtare, klikoni opcionin “ Transferet ndërkombëtar”

në IBAN si psh Kina dhe Amerika. Nëse e keni vetëm numrin e llogarisë së përfituesit , sistemi ju kërkon që të konfirmoni se klienti nuk ka IBAN dhe mund të vazhdoni regjistrimin e transferit.

⁵ **SWIFT** kodi apo BIC kodi i bankës së përfituesit përbëhet nga 8 ose 11 karaktere, nëse i keni vetëm 8 karaktere të bankës së përfituesit , tri karakteret e fundit i shenoni me XXX, përndryshe nëse nuk e plotëson këtë kriter SWIFT kodi i bankës së përfituesit është gabim!


⁶ Janë tri lloje të shpenzimeve, ju duhet ta zgjidhni një të opion , varësisht se si jeni dakorduar me përfituesin:

SHA/BEN- është rasti kur ju i mbulonit vetëm shpenzimet e Bankës Urdhëruese – Bankës Ekonomike,

OUR- është rasti, kur ju i merrni përsipër të gjitha shpenzimet e bankave të ndërlidhura me transferin

⁷ **ITRS**- janë kodet e Bankës Qendrore që kërkohen të vendosen për secilën transfer ndërkombëtar, ju duhet të përzgjedhni kodin që e përshkruan më së miri arsyen e pagesës!

⁸ Nëse pagesa bazohet në dokument të pagueshëm, faturë apo kontratë, duhet të cekni me PO ose JO, nëse përgjegjja është PO, vazhdoni me plotësimin e të dhënave si: referencën e dokumentit, shumën e cekur në dokument, datën e dokumentit.



Për të vazhduar me regjistrimin e transferit, klikoni opcionin **Vazhdo**, ku ju paraqiten llogaritë e hapura rrjedhësë EUR/USD/GBP dhe CHF, dhe ju duhet të përzgjidhni llogarinë e juaj rrjedhëse nga e cila do të debitetohet për shumën e transferit dhe komisionit bankar:

Te fusha **Llogaria/IBAN**: kërkohet të shenohet numri i llogarisë së përfituesit apo IBAN-i.

Te fusha **Kërko Bankën** – duhet të shënoni SWIFT kodin e bankës së përfituesit me 8 ose 11 karaktere, dhe të klikoni butonin për të kërkuar:

Te fusha **Vlera**: -duhet të shënoni shumën që dëshironi të transferoni

Te fusha **Arsyeja**: duhet të shenoni arsyen e pagesës


Te fusha **Shpenzimet**: duhet të përcaktoni njërin lloj të shpenzimeve (SHA/OUR/BEN)

Te fusha **ITRS Code**: duhet të përzgjedhni kodin që ju përgjigjet më së shumti natyrës së pagesës

Të fusha: **Dokument i Pagueshëm**,

Shembull i regjistrimit të transferit ndërkombëtar:

Për të pranuar regjistrimin e pagesës , klikoni butonin Prano dhe ju hapet dritarja në vijim:



The screenshot shows the 'Informata E Ekzekutimit' (Execution Information) screen in the eBanking portal. The interface includes a navigation menu on the left with options like 'Transferi personal', 'Transferi ndërkombëtar', 'Transferi vendor', 'Gjyho pagesat', 'Pagesat e faturave', and 'Transferi brenda bankës'. The main content area displays the following information:


- Informata E Ekzekutimit:**
 - Faza e procesit: Debiti dhe llogji (checked), Të dhënat e transferit, Informatat e ekzekutimit.
 - Lloji i transferit: Transferi ndërkombëtar.
 - Debit: Klienti: [redacted], Llogaria: XK0514010000000050 EUR LLOGARI RRJEDHESE, Bilanci aktual i llogarisë: 9,862,14 EUR.
 - Përfutuesi: Llogaria/BAN: IT69 N010 3040 0210 0000 0235 648, Banka përfutuese: PASCTM1N06, Emri dhe Adresa: FILAN FISTEKU, ITALY. Beneficiary details: BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.P.A. (CIS NOLA), PRESSO C.I.S. CENTRO INGROSSO SVILUPPO NOLA.
 - Shuma totale (1 Pagesë): 1,006,41 EUR.
- Ekzekutim dhe autorizim:**
 - Udhërsatë e vetme (selected) / Udhërsatë automatike.
 - Transferi do të ekzekutohet më: 24.05.2016.
 - Ekzekutimi do të varret në fondet e disponueshme në llogarinë debitore në momentin e ekzekutimit. Transferi do të ekzekutohet vetëm njëherë në datën e specifikuar.
 - Pagesë e autorizuar tek 60/60 për datën e zjedhur.
 - Buttons: Anulo, Data e transferit, Dërgo transferin.

Për ta dërguar pagesën për procesim të metutjeshem, në Bankë, klikon opcionin Dërgo transferin dhe transferi do të procesohet në përputhje me Kushtet e përgjithshme të Bankës Ekonomike.


Nëse dëshironi ta anuloni regjistrimin e pagesës klikoni tek opcioni Anulo.


8.7. Pagesat e shumëfishta

Nese keni më shumë se një pagesë (për klient brenda Bankës Ekonomike, për klient për banka tjera në Kosovë apo edhe për transfere ndërkombëtare) mund të përdorim opcionin **Pagesa të shumëfishta** dhe na lejon që të regjistrojm me shumë së një transfer njëherësh:




Për të vazhduar me regjistrimin e transferit , klikojm butonin **+Transfer i ri** , dhe na paraqiten fushat për plotësimin e transferit përkatës, në këtë rast të transferit për klienta brenda Bankës Ekonomike:






Për të vazhduar me plotësimin e pagesës, klikojmë në opcionin Shto faturën dhe na paraqitet dritarja në vijim:



Për të vazhduar me regjistrimin e transferit të dytë, klikojmë në opcionin Transfer i ri dhe na paraqitet dritarja e njëjtë për plotësim. Mund të vazhdojmë të shtojmë pagesa tjera, në bazë të këtij procesi, por në fund çdo herë duhet të vazhdojmë procesimin duke klikuar opcionin **Vazhdo** dhe na paraqitet dritarja në vijim:




Për të procesuar pagesat e shumëfishta, klikoni butonin **Vazhdo** dhe pagesat do të procesohen, në përputhje me Kushtet e përgjithshme të bankës. E njëjta procedurë vlen edhe për pagesat vendore dhe ndërkombëtare!


8.8. Krijimi dhe ruajtja e transferit të shpeshtë

Platforma E-banking ju mundëson që të krijoni shabllone të transfereve të ndryshme për ti menaxhuar me lehtë dhe me shpejt transferet e juaja.

Pas regjistrimit të cilit do transfer, ju mund ta ruani si **Shabllon** si në dritaren në vijim:



Pasi të klikoni **Ruaje transferin e shpeshtë** ju paraqitet dritarja në vijim:




The screenshot shows the 'Ruaje Transferin E Shpeshte' form in the eBanking interface. The form is titled 'Ruaje Transferin E Shpeshte' and contains the following fields and information:

- Lloji i transferit:** Transfer personal
- Debit:**
 - Klienti: 50 LINDITA MEHMETI
 - Llogaria: XK05140100000005029 EUR LLOGARI RRJEDHESE
 - Bilanci aktual i llogarisë: 9,698,14 EUR
- Perfituesi:**
 - Klienti: 50 LINDITA MEHMETI
 - Llogaria: XK05140100000005029 EUR LLOGARI KURSIMI
- Shuma totale (1 Pagesë):** 5,00 EUR
- Emri i transferit të shpeshtë:** bartje ne kursim
- Buttons: Anulo, Ruaje transferin e shpeshte

Tek fusha **Emri i transferit të shpeshtë** mund të vendosni emrin e transferit për përdorim më të lehtë.

Për të ruajtur shabllonin e transferit, klikoni butonin **Ruaje transferin e shpeshtë** dhe do ju paraqitet dritarja në vijim ku ju informon se është ruajtur me sukses.




The screenshot shows the 'Transferi I Shpeshte U Ruajt' confirmation message in the eBanking interface. The message is titled 'Transferi I Shpeshte U Ruajt' and contains the following information:

- Transferi i shpeshtë 1383 është ruajtur me sukses.
- Emri i transferit të shpeshtë: BARTJE NE KURSIM
- Buttons: + Transfer i ri, Shiko te menzahimi i transferit të shpeshtë, Shiko te statusi i transferëve

8.9. Kopja e transferit

Platforma E-banking ju mundëson që të kopjoni transferet e ndryshme, duke ju mundësuar shfrytëzimin e të dhënave të njëjta të përfituesit. Por duhet të keni kujdes se mund ta dërgoni transferin me të dhëna komplet të njëjta edhe njëhër. Kur ta shfrytëzoni këtë opcion, kontrolloni të gjitha fushat, sidomos fushën e vlerës së transferit dhe fushën e arsyes së transferit!



Pasi të klikoni butonin Kopja e transferit, ju paraqiten komplet të dhënat e transferit paraprak, të cilat keni mundësi ti ndryshoni sipas rastit dhe vazhdoni procesimin e transferit përkatës siq janë të përshkuara me lartë.

9. Regjistrimi i faturave KOS GIRO

Disa kompani Publike (KEDS, PTK, KUR, Dogana e Kosovës etj), dhe Private (si Kompanit e sigurimeve), janë licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës që të lëshojn fatura në standardin Kos Giro. Forma dhe dizajni i faturave ndryshon nga njëra tjetra, por secila faturë KosGiro duhet të përmbajë informatat kryesore si:

- Emrin dhe mbiemrin (emrin e organizatës) e paguesit
- Shifra e konsumatorit
- Shumën e pagëses
- Referencën
- Barcodin (për lexim automatik)
- Emrin e kompanisë që e ka lëshuar faturën
- Numrin e llogarisë së kompanisë që e ka lëshuar faturën (në rast se ka më shumë se një llogari, si KEDS psh)



Procesimi i pagesave KOS Giro në E-banking bëhet duke i përdorur informatat standarde të cilat gjinden në faturën Kos Giro si: Shumën dhe Numrin e referencës,

emri dhe mbiemrin (emrin e kompanisë). Më poshtë i gjeni të sqaruara veçorit kryesore të secilës faturë.

9.1. Pagesa e faturave KOS GIRO të lëshuara nga KESC

Kompania KESC-o (Kosovo Electricity Supply Company) është e autorizuar të lëshoj fatura KosGiro për të gjithë njëhsorët e rrymës elektrike në Kosovë, por kjo kompani është e ndarë në distrikte rajonale dhe faturat i lëshon sipas rajoneve, prandaj duhet të keni kujdes se për cilin district jeni duke e paguar faturën e rrymës.

Fatura e KESC-os duket si më poshtë, ndërsa në formën e zmadhuar gjenden informatat që ju duhen për ta procesuar pagesën KOS Giro:




Tek Fusha **Utility ID** - është emri i kompanisë dhe rajoni, ndërsa më poshtë është e shënuar edhe numri i llogarisë bankare të kompanisë përkatëse.

Tek fusha **Reference** : është e shënuar referenca 16 shifrore që ndërlidhet me debitorin (personin fizik apo kompaninë)


Tek fusha **Shuma**: është e shenuar shuma e përgjithshme e obligimit ndaj kompanis
Në fund është e ri-shenuar edhe njëher referenca 16 shifrore e faturës KOS GIRO

Procesimi në E-banking.

Për të vazhduar procesimin e pagesës KOS GIRO duhet të zgjedhni opcionin GYRO Pagesat dhe hapet dritarja në vijim:



Për të vazhduar procesimin , klikoni butonin Vazhdo, pastaj hapet dritarja tjetër, ku keni mundësi që të përzgjedhni kompanin përfituese të mjeteve,




Pastaj, vazhdoni me plotësimin e fushave si:

Numri i Referencës- shenoni referencën 16 shifrore të specifikuar ne faturën Kos Giro

Vlera: shenoni shumën që paguani

Arsyeja: shenoni arsyen e pagesës:



Transfer

Faza e procesit: ✓ Debiti dhe lloji Te dhënat e transferit Informatat e ekzekutimit

Lloji i transferit: Gyro pagesat

Debit

Klienti: [Redacted]

Llogaria: XK05140100000005029 EUR LLOGARI RRJEDHESE Bilanci aktual i llogarisë: -1.056,85 EUR

Kredit

Emri dhe Adresa: KESCO Divizioni Prishtine (XK051901682103031369)
KESCO J.S.C., Divizioni Prishtine
Banka Kombëtare Tregtare Prishtine

Numri i referencës: DPR000023303512M


Paguar nga: 50 LINDITA MEHMETI

Vlera

Vlera: 27.000 EUR

Përshkrimi: PAGESA E MUAJIT DHJETOR 2016

Pas plotësimit të këtyre fushave, për të vazhduar klikoni, butonin Vazhdo dhe prap sistemi ju kërkon një pranim nga ana juaj si konfirmim se të dhënat janë të shenuara saktë:



Informata E Ekzekutimit

Faza e procesit: ✓ Debiti dhe lloji ✓ Te dhënat e transferit Informatat e ekzekutimit

Lloji i transferit: Gyro pagesat

Debit

Klienti: [Redacted]

Llogaria: XK05140100000005029 EUR LLOGARI RRJEDHESE Bilanci aktual i llogarisë: -1.056,85 EUR

Perfituesi

Llogaria/IBAN: XK051901682103031369 Banka përfituese: 19
Emri dhe Adresa: KESCO J.S.C., Divizioni Prishtine Banka Kombëtare Tregtare Prishtine

Shuma totale (1 Pagesë) 27,00 EUR

Ekzekutim dhe autorizim

Urdhëresë e vetme Urdhëresë automatike

Transferi do të ekzekutohet me 24.05.2016

Ekzekutimi do të varet në fondet e disponueshme në llogarinë debitore në momentin e ekzekutimit

Klikoni Dërgo Pagesën dhe pagesa do të procesohet në përputhje me Kushtet e përgjithshme të bankës për pagesat Kos Giro.

9.2. Procesimi i Faturave KOS Giro të lëshuar nga Dogana e Kosovës

Edhe Dogana e Kosovës është e licencuar nga BQK-ja për lëshimin faturave me standardin Kos Giro. Për procesimin e këtyre faturave, duhet të zgjedhni opcionin për pagesat KOS Giro, dhe pastaj duhet të përzgjedhni : Dogana e Kosovës (XK051000410070001295)⁹. Shembulli i faturës kos giro të lëshuar nga Dogana e Kosovës:

⁹ Në kllapa gjindet çdo here numri i llogarisë së kompanisë që e ka lëshuar faturën KOS GIRO

2		Urdhërpagesë:		152020000037764Y	
Obliguesi doganor "GOMAR KOSOVA" SH.P. UÇK, KOMPLEKSI QAFJA KATI I , PRISH.			Zyra doganore: 2020-ZBD PRISHTINE Datë 03/12/2015 Printuar me 03/12/2015 14:22		
					
Kodi	Lloji taksave	2015	R	49737	E pagueshme/EUR
CD	Dogana				3,853.63
VT	TVSH				6,303.06
ED	Akciza				125.79
Totali i pagueshëm					10,282.48
Shuma totale e të bollave duhet të transferohet në llogarinë e Doganës Nr. 100410070001295 Asepjë pagesë nuk duhet të pranohet pa këtë informata					
2	Lëshuar nga		Pranuar nga:		3
	Nënshkrimi	Vula	Nënshkrimi	Vula	
4	<input type="checkbox"/> Kesh <input type="checkbox"/> Transf <input type="checkbox"/> Çek <input type="checkbox"/> Tjera		Konfirmuar		
5	Pranuar nga		Banka		
	Vula		Arkëtari	Datë	Vendi
			Vula		
Kos-GIRO					
Shuma					
1 0 2 8 2 . 4 8			Ju lutem përdorni ngjyrë të kalçer në plotësimin e pagesës		
Nga llogaria bankare			Nënshkrimi		
Nga			_____		
Emri			_____		
Adresa			_____		
Vendi			_____		
Për 00101 KOSOVO CUSTOMS 10004100700012 152020000037764Y 03/12/2015					
152020000037764Y+0000000000000009&<00102&24&+00101+1&					

Bazuar në shembullin e faturës me lartë, vazhdojmë me procesimin e faturës në E-banking ,

Pasi të zgjidhet kompania përfituese: Dogana e Kosoves (XK051000410070001295), vazhdoni plotësimin e fushave tjera:


Te fusha **Numri Referencës**: shenoni referencën 16 shifrore që gjendet në pjesën e sipërme të faturës pas fushës ku shenon Urdhërpagesë, por e njëjta shifër gjendet edhe në pjesën e fundit të faturës, që në këtë rast është: **152020000037764Y**

KOMPANIA E SIGURIMEVE / INSURANCE COMPANY		Nr. TVSH-ave / Br. PDV-a / VAT No. 330029985	
Nr. 02348603		010130102348603P	
RR.TUTINI P.N PRISHTINE		Nr. Referencës / Referentni Br. / Reference No.	
RR.TUTINI P.N PRISHTINE		Nr. Personal / Lični Br. / ID No.	
Prishtine, 044 Prishtine		Nr. Biznesi / Br. Biznesa / Business No.	
Adresa e përfaqësues / Adresa predstavnístva / Branch Office Address		Nr. Fiskal / Fiskalni Br. / Fiscal No.	
Kontraktuesi / Ugovaraç / Contractor		TË DHËNAT FINANCIARE / FINANCIJSKI PODACI / FINANCIAL DATA	
I siguruari / Osiguraniç / Insured		156.00 Primi bazë / Osnovna premija / Basic premium	
TË DHËNAT PËR AUTOMJETIN / PODACI O VOZILU / VEHICLE DATA		00.00 Primi shtesë / Dodalna premija / Added premium	
01-256-00 Targa e Regjistrimit / Registarska tablica / Registration No.		14 Bonus Malus - Shkalla / Skala / Rate	
Automjet për pasagjerë Klasifikimi i automjetit / Klasifikacija vozila / Sort of Vehicle		110.00 % Bonus Malus - Përqindja / Postotak / Percentage	
DAMLERCHRYSLER Marka dhe tip / Marka i vrsta / Mark and type		15.60 Bonus Malus - Vlera / Vrednost / Amount	
WDB2030061FD52541 Numri i shasisë / Broj šasije / Chassis No.		171.60 Primi / Premija / Premium	
2149.00 Shënimet teknike / Tehnički podaci / Technical data		30.89 TVSH / PDV / VAT	
Personal Qëllimi i përdorimit / Namena (upotrebe) vozila / Assignment		202.49 Gjithsej / Ukupno / Total	
10.03.2016 Lëshuar më / Izdato / Issued on	Avni Pacolli Lëshuar nga / Izdato od / Issued by	Vula / Peçat / Stamp	Nënshkrimi / Potpis / Signature

Kos-GIRO		Shuma / Iznos / Amount	
01013010 2348603P	€ 202 Euro 49 Ct	Ju lutemi përdorni ngjyrë të zezë ose të kaltër për plotësimin e këtij formulari. Upotrebitis crno ili plavo masilo za ovaj formu. Please use blue or black ink to fill in this form.	
202 49	Prej / Xhironlogarisë / Od zira računa / From bank account	Nënshkrimi / Potpis / Signature	
000598 Siguria	Emri / Ime / Name	A i kemi përfunduar të gjithë bashkë e bashkë? Dak se popunili besa zajedno? Have you filled in all white sections?	
000598 Siguria	Adresa / Adresa / Address	K	
1401000000853391	Vendi / Mesto / Place	Për / Za / To	
01013010 2348603P	PRISHTINE	01013010 10.03.2016	
010130102348603P	000598+0000000000000098<00202497+	000598+13>	

Nr i referencës është i shënuar në 4 vende të ndryshme , të cilat i kemi rumbullaksuar për ta gjetur më lehtë, por kujdes,çdo herë përbëhet nga 16 shifra dhe është e njëjta referencë që duhet të shenohet në E-banking.

Për regjistrimin e pagesës Kos Giro në E-banking, vazhdoni me përzgjedhjen e llogarisë suaj rrjedhëse në EUR, pastaj zgjedhni Tipin e pagesës Kos Giro, dhe do ju hapet dritarja për regjistrimin e KOS Giro-s. Fillimisht duhet të përzgjedhni kompanin që e ka lëshuar faturën Kos nga fusha: Emri dhe Adresa si në dritaren me poshtë:




Mund të ketë agjensione tjera që janë të autorizuar për të lëshuar fatura KOS Giro, por procesi i regjistrimit të këtyre faturave është i njëjtë!

10. Realizimin e pagesave të faturave për Agjensionet e ndryshme buxhetore

Agjensionet e ndryshme buxhetore si Ministrinë, Komunitat, Administrata Tatimore e Kosovës, Trusti Pensional i Kosovës e agjensione tjera buxhetore për të hyrat e tyre lëshojnë fatura (FLETËPAGESA) me informata standarde si:

- Llogon e Republikës së Kosovës, Komunës apo Univeristetit
- Emri i Agjencionit Buxhetor që lëshon fletëpagesën
- UNIREF-i shifra 16 shifrore tek barcodi
- Numri i llogarisë së Agjencionit Buxhetor
- Shuma e pagesës
- Detajet e pagesës janë të varura nga lloji i pagesës, por kryesisht kërkohen:
 - Emri , mbiemri
 - Përshkrimi i pagesës
 - UNIREF-i
 - Shuma

Referenca Unike prej 16 shifrave e njohur si UNIREF për të cilin agjencion buxhetor fillon me dy apo tri karaktere unike, këto karaktere janë të parashnuara dhe ndërlidhura për llogarinë përkatëse për të mos e gabuar llogarinë e përfituesit.



1001228745 (Hyrja e fundit: 24.05.2016 18:28) 50 50 LINDITA MEHMETI Dini

Banka Ekonomike

LLOGARITË TRANSFERET

Transfer personal Transfer ndërkombëtar

Transfer vendor Gyro pagesat

Pagesat e faturave Transfer brenda bankës

Ndihma

Transfer

Faza e procesit

Lloji i transferit: T

Debit: 50.00

Klienti: 50 LINDITA MEHMETI

Llogaria: XK051000420070000373

Kredit

Emri dhe Adresa: Komuna e Lipjanit

Detajet

Emri/Mbiemri:

Numri Serik:

Municipality:

Revenue code:


Description:

*UNREF: LP

Paguar nga:

Vlera / Përshkrimi

Pasi perzgjedhjes së Agjencionit përkatës buxhetor, në këtë rast Adminsitratës Tatimore të Kosovës, hapet dritarja si në figurën e më poshtë:



1001228745 (Hyrja e fundit: 24.05.2016 18:28) 50 50 LINDITA MEHMETI Dini

Banka Ekonomike

LLOGARITË TRANSFERET

Transfer personal Transfer ndërkombëtar

Transfer vendor Gyro pagesat

Pagesat e faturave Transfer brenda bankës

Ndihma

Transfer

Faza e procesit

Lloji i transferit: T

Debit: 50.00

Klienti: 50 LINDITA MEHMETI

Llogaria: XK05140100000005 EUR LLOGARI RRJEDHESE

Bilanci aktual i llogarisë: 10.959,94 EUR

Kredit

Emri dhe Adresa: Administrata Tatimore e Kosoves (XK051000420070000373)

Administrata Tatimore e Kosoves

Detajet

*UNREF: MFA2HB0054368043

Paguar nga:

Vlera / Përshkrimi

Vlera: 27.00 EUR


Anulo Debiti & llogji

Vazhdo

Tek fusha UNIREF shenoni shifrën 16 shifrore (vazhdoni plotësimin e saj, pasi që tri shkronjat unike janë të parashkruara).

Tek fusha shuma shenoni shumën që dëshironi ta paguani, dhe klikoni tek butoni Vazhdo, për të ju paraqitur fig në vijim:

Nëse fletëpagesa është leshuar nga sistemi i Administratës Tatimore “EDI”, të dhënat e juaja paraqiten në mënyrë automatike si në këtë figurë:



The screenshot shows the eBanking interface for a payment transaction. The browser address bar shows the URL: 10.0.0.117:8081/app/payment?execution=e8s4. The page title is 'TRANSFERET'. The main content area is titled 'transfer' and shows the following details:

- Faza e procesit:** Debiti dhe lloji → Të dhënat e transferit → Informatat e ekzekutimit
- Lloji i transferit:** Pagesat e faturave
- Debit:** Klienti: [redacted], Llogaria: XK0514010000000000 EUR LLOGARI RRJEDHESE, Bilanci aktual i llogarisë: 10.959,94 EUR
- Kredit:** Emri dhe Adresa: Administrata Tatimore e Kosoves (XK0510004200700003), Administrata Tatimore e Kosoves
- Detajet:**
 - Nr. Biznesit: 00000000
 - Naming: NTP, [redacted]
 - Numri Serik: [redacted]
 - Periudha: 2/2016
 - Lloji i tatimit: *UNREF: MFA2H80054368043
 - Paguar nga: [redacted]
- Vlera / Përshkrimi:** Vlera: 27.000 EUR
- Buttons: Anulo, Debiti & lloji, Vazhdo

10.2. Regjistrimi i pagesave për ATK

Regjistrimi i pagesave për Administratën Tatimore të Kosovës dhe Trustin Pensional të Kosovës, janë të ndërlidhura me aplikacionin e Administratës Tatimore të Kosovës të njohur si EDI.

Nëse fletëpagesën e keni marr nga ky aplikacion, detajet e pagësës do të bartën automatikisht nga EDI dhe do të plotësohen fushat përkatëse si:

Periudha Tatimore

Numri Fiskal

Emri i Biznesit

Data e Deklarimit


Ju duhet të plotësoni vetëm shumën që dëshironi ta paguani.

Nëse pagesa është printuar nga Zyrtarët e Administratës Tatimore, këto të dhëna duhet ti plotësoni manualisht, sikurse për pagesat tjera.

Pas shenimit të UNIREFIT , shenoni shumë tek fusha Vlera: dhe klikoni ne butonin Vazhdo

Pas regjistrimit të secilës nga këto tri lloje të transfereve, mund të regjistroni transferin si Pagesë Periodike. Për të vazhduar me procesimin e pagesës periodike, klikojmë opcionin Dërgo Pagesën dhe na paraqitet dritarja në vijim:

Nëse klikoni opcionin pagesë e përheshme, automatikisht do të paraqitën opsionet për parametrizimin e pagesës periodike, duke filluar nga përcaktimi i datës së parë të ekzekutimit, pastaj përcaktimin e frekuencës së procesimit, mujor, 2 mujore, vjetore si dhe afatin e përfundimit të pagesës periodike. Këto funksione të veçanta do ju mundësojnë menaxhimin me të lehtë të llogarisë dhe transfereve tuaja.



The screenshot shows the 'Dërgo transferin' (Send transfer) screen in the eBanking application. The interface is in Albanian and displays the following information:

- Account Information:**
 - Llogaria: XK051401000000005039 EUR LLOGARE KRUEHESHE
 - 9.674.14 EUR
 - Portfili: Llogaria (IBAN): XK051401000000005039, Banka portfili: 14 Banka Ekonomike Prishtine
 - Shuma totale (1 Pagesë): 50.00 EUR
- Ekzekutim dhe autorizim:**
 - Transferi i parë
 - Data filltare e ekzekutimit të transferit: 25.05.2016
 - Ekzekutim i transferit: Transferi përfundon: Mujore
 - Transferi përfundon: Pë kushtë
 - Ekzekutimi do të varret në fondet e disponueshme në llogarinë debitore në momentin e ekzekutimit
- Buttons:**
 - Anulo
 - Dërgo transferin